

VENDIM
Nr.840, datë 24.4.2009

**PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË OPERATORIT TELEVIZIV PRIVAT
KABLLOR “TV STAR”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të zonave të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.780, datë 25.2.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Star-E.L.I” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “TV STAR” me nr.015/RTVK licencë, për në komunat Frakë, Kashar, qarku Shkodër, bashkia Fier.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Licencave, Drejtoria Teknike, Drejtoria Ekonomike për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)